



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AEK Group" Sh.P.K. të datës 20.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 18.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest" me nr. të prokurimit 616-22-14667-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 219 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AEK Group" Sh.P.K. e datës 20.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 18.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest" me nr. të prokurimit 616-22-14667-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 219 211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues për nënshkrim të kontratës duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën hyn në fuqi ky vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "AEK Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AEK Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 20.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues rivlerësim të datës 18.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest" me nr. të prokurimit 616-22-14667-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 219 211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë - “Në bazë të nenit 65-71 dhe 72 të LPP, dokumenti që ne kemi dorëzuar (fjala është për NIOSH 9002 ISO certifikat 29993) me datë 14.04.2023 konsiderohet si qartësim i certifikatave dhe dokumentacionit të paraqitur dhe jo si dokumentacion shtesë”.

Pretendimi i dytë - “Ne kemi kërkuar çasje në dokumentet zyrtare dhe kemi tërhequr dosjen e Grupit OE Ar-Tech-Bioinvest Institute – Institut MOL. Pas shqyrtimit të dosjes së tyre, kemi vërejtur se në dosjen e dorëzuar grupi i lartëpërmendur nuk posedon të gjitha dokumentacionet siç janë kërkuar në tender, e ato janë:

- Një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit;
- Një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtar, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtë të prokurimit;
- Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit;
- Deklaratat e dorëzuara në ATK apo konfirmimin nga banka për qarkullimin e kërkuar (e ka dorëzuar të pa nënshkruar, pa vulosur dhe konfirmuar nga banka);
- Eksperti i paraqitur për azbest nuk është ekspert i fushës”.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 deri 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 26.03.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Njoftimi për kontratë i dt. 29.12.2022;
- Dosja e tenderit e dt. 07.02.2023;
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i dt. 07.02.2023;
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i dt. 20.02.2023;
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i dt. 09.03.2023;
- Oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar;
- Letër standarde e kërkesës për informata sqaruese i dt. 12.04.2023;
- Përgjigja në letrën standarde për sqarimin e tenderit me dokumentet e bashkangjitura;
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i datës 18.04.2023;
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 18.04.2023;

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të Rregullores (A01) nr.001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Sa i përket pretendimit të parë duhet cekur se në formulimin e pretendimit të parashtruesit (shih faqen nr. 4 të kërkesës për rishqyrtim, seksioni 7 – deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet), vërehet se vet parashtruesi konfirmon se e ka dorëzuar një dokument të caktuar pas hapjes së ofertave pasi që fjalinë e fillon me “*dokumenti që ne kemi dorëzuar me datë 14.04.2023*” (fjala është për NIOSH 9002 ISO certifikat 29993). Në këtë mënyrë parashtruesi paradoksalisht në kuadër të pretendimit të tij e kundërshton faktin që ka dorëzuar dokument shtesë duke e konfirmuar se me datë 14.04.2023 e ka dorëzuar dokumentin për të cilin bëhet fjalë. Duhet shtuar se dokumenti përkatës (NIOSH 9002 ISO certifikat 29993) ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit lidhur me kërkesat mbi kapacitetet teknike dhe profesionale dhe ky fakt si i tillë nuk kontestohet as nga vet parashtruesi. Me fjalë të tjera as parashtruesi nuk e konteston që ky dokument është dashur të përfshihet në dosjes kur është dorëzuar oferta gjatë kohës sa ka qenë i hapur afati për dorëzimin e ofertave. Mirëpo në njërin anë hapja e ofertave sipas procesverbalit për hapjen e ofertave është bërë me datë 13.03.2023. Në anën tjetër vet parashtruesi e konstaton që dokumentin në fjalë e ka dorëzuar me datë 14.04.2023. Kjo nënkupton që ky dokument është dorëzuar më se një (1) muaj pas afatit përkatës dhe konsiderohet dokument shtesë. Mbi këtë bazë komisioni vlerësues ka gjetur se një veprim i tillë i parashtruesit është në kundërshtim me LPP. Përndryshe mund të thuhet se komisioni nuk ka qenë fare i obliguar të dërgoj te parashtruesi letër standarde për sqarime shtesë lidhur me këtë fakt. Rrjedhimisht ky veprim i komisionit nuk ka qenë i domosdoshëm pasi që ka pasur mundësi vetëm të konstatohet se ky kriter në dosjen e tenderit të parashtruesit mungon dhe për pasojë ofertues në fjalë nuk është rekomanduar për kontratë. Sidoqoftë, sikurse ka konstatuar edhe komisioni, fakti që parashtruesi ka dërguar një dokument të tillë pas afatit për dorëzimin e ofertave nuk është në përputhje me LPP në asnjë aspekt. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të dytë se tenderuesit të rekomanduar i mungojnë disa dokumente që janë pjesë e dosjes së tenderit apo që një dokument nuk është dorëzuar si duhet si dhe eksperti i prezantuar nuk është ekspert i fushës sipas dosjes së tenderit, është analizuar me kujdes raporti i komisionit të vlerësimit si dhe oferta e tenderuesit të rekomanduar. Me këtë rast është gjetur se tenderuesi i rekomanduar sipas konstatimit edhe të komisionit vlerësues i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderit përkatësisht ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT dhe FDT. Në këtë mënyrë është gjetur se edhe pretendimi i dytë i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.04.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.